

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ish-ministri i Ramës ngre alarmin për SHISH: Gjëmë e madhe, inteligenca kombëtare jashtë kontrollit
ADRESA	https://piranjat.al/politike/ish-ministri-i-rames-ngre-alarmin-per-shish-gjeme-e-madhe-i-inteligenca--i106490
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 19:13:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 19:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	27211533a324f6104f683ed46e2ad0a6841840b52d0c02f4dc689ecf798de851
TEKSTI	92006d637028450d8347d55e36c860d888f294d78812649c85a195d58781ba9c
PAMJA	e66525e4c3d0dc3c74bee0b78429b9158b59f788ac3e7262fa76747cef94a076

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e9739bd44747edd9672703fe94b5b1a5a62f374f93001f204f1ff3c18e858761
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e9739bd44747edd9672703fe94b5b1a5a62f374f93001f204f1ff3c18e858761>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: Gjeme e madhe, reformim të thellë të Shërbimit Inteligjencia ■ drejt "Qytetit Studenti": qytetarët kanë vijuar marshimin ■ Skenderbeu sheshin "Skenderbej" nga ku kërkohet dorëheqja e ■ plagjiaturen SPAK pas publikimit të investigimit nga emisioni ■ e ministres Spahiu PD ■ Irane reagon për Vlorë rreth çështjes së ish-

POLITIKE

Ish-ministri i Ramës ngre alarmin për SHISH: Gjëmë e madhe, inteligjencia kombëtare jashtë kontrollit

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 21:06



Ish-ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, ka kërkuar një reformim të thellë të Shërbimit Informativ të Shtetit, duke deklaruar se ndërhyrja në këtë institucion duhej të ishte bërë që 30 vite më parë.

Duke folur në emisionin "Off the Record" të Andrea Dangllit në A2CNN, Lleshaj u ndal në ndalimi i drejtueses së Shërbimit Informativ, të cilin e cilësoi një zhvillim të paprecedentë që nuk mund të trajtohet si një ngjarje e zakonshme.

Sipas tij, pavarësisht interpretimeve të ndryshme që po i bëhen çështjes, fakti që drejtuesja e institucionit kryesor të inteligjencës është vendosur nën akuzë për lidhje me krimin kërkon një reagim serioz të shtetit.

"Ne nuk duhet ta marrim lehtë këtë që po shohim, këtë që po zhvillohet ndërkohë që ne flasim. Pavarësisht se zëra të ndryshëm e përkthejnë në trajta nga më të ndryshmet. Disa e përkthejnë si një fitore të madhe, si një arritje të madhe; disa e përkthejnë si një gjëmë të madhe; disa ndoshta e shohin sikur nuk ka ndodhur gjë. Por kjo është një situatë e cila nuk mund të neglizhohet si zakonisht. Është një situatë e veçantë, sepse kemi të bëjmë me diçka të paprecedentë", tha Lleshaj.

Ish-ministri përdori tone edhe më të forta kur foli për përplasjen mes drejtueses së Shërbimit dhe SPAK-ut. Për Lleshajn, vetë fakti që sistemi ka arritur në këtë pikë tregon se kemi të bëjmë me një ngjarje shumë më të madhe sesa një procedim penal individual.

"Ndalimi i Shefit të Shërbimit Informativ është një ngjarje e paprecedentë. Ngado që ta marrësh, diçka është çmëndur këtu: ose është çmëndur shefja e Shërbimit Informativ ose është çmëndur SPAK-u, ose janë çmëndur të dy. Por kjo gjë nuk është diçka që mund të kalojë me fjali të thjeshta dhe të përsëritura. Është një gjëmë e madhe. Shefi i Shërbimit Informativ të Shqipërisë është arrestuar për bashkëpunim me banda kriminale. Të paktën ky është dyshimi i Prokurorisë së shtetit shqiptar dhe i një gjykate shqiptare", deklaroi ai.

Lleshaj kërkoi që çështja penale të ndahet nga problemi institucional. Sipas tij, me përgjegjësinë penale duhet të merren Prokuroria dhe Gjykata, ndërsa shteti duhet të përqendrohet menjëherë te pasojat që ngjarja mund të ketë shkaktuar brenda sistemit të inteligjencës.

"Kjo nuk është vetëm çështje penale. Është reduktim deri në nivelin e papërgjegjshmërisë ta quajmë vetëm penale. Kjo është në radhë të parë një çështje e shtetit, e politikës, e administratës, e moralit politik, e moralit shoqëror. Ka shumë dimensione të cilat duhen marrë në konsideratë. Më imediatja është të ruajmë Shërbimin. Rëndësia e dorës së parë sot është që të ndalojmë dëmin e mëtejshëm, sepse është konstatuar një çarje e madhe në sistemin e inteligjencës kombëtare", u shpreh ish-ministri.

Një prej pikave më alarmante të ngritura prej tij lidhet me informacionet që mund të kenë dalë nga SHISH. Lleshaj tha se duhet përcaktuar menjëherë shkalla e dëmit, pasi funksionimi i një shërbimi inteligjent mbështetet pikërisht mbi sekretin dhe besimin.

"Pastaj duhet verifikuar deri ku ka shkuar dëmi. Duhet të dimë që Shërbimi jeton nga konfidenca, nga sekreti. Në qoftë se ne kemi pasur një shërbim prej të cilit kanë rrjedhur informacionet, besoj mund të kenë rrjedhur dhe informacionet për bashkëpunëtorët e tij, që do të ishte një goditje fatale për gjithë sistemin e sigurisë dhe të inteligjencës kombëtare. Duhet parë niveli i dëmit dhe duhet filluar puna për riparimin e tij", deklaroi Lleshaj.

Por për ish-ministrin problemi shkon përtej ngjarjes së fundit. Ai argumenton se vetë baza ligjore mbi të cilën funksionon SHISH është e vjetruar dhe se reforma e Shërbimit është vonuar për dekada.

Sipas tij, ligji për SHISH është miratuar në vitin 1998, përpara Kushtetutës aktuale, dhe mbështetet te dispozitat kushtetuese të vitit 1991.

"Duhet një reformim dhe është dashur jo sot, por është dashur para 30 vitesh. Nuk është bërë. Shërbimi Informativ i shtetit shqiptar është themeluar me një ligj në vitin 1998, përpara se Shqipëria të

bëhej me Kushtetutën që ka sot. Ligji i Shërbimit Informativ të Shtetit bazohet në dispozitat kushtetuese të 1991, që ishin rrënojat e Kushtetutës së 1976-ës të Enver Hoxhës. Ky ligj i Shërbimit nuk ka lidhje me Kushtetutën tonë. I referohet një Kushtetute tjetër, të rrëzuar, dhe nuk është prekur kurrë”, tha ai.

Lleshaj ngriti gjithashtu alarmin për mungesën e kontrollit mbi SHISH, duke deklaruar se ligji aktual i jep institucionit kompetenca që mund të bëhen të rrezikshme për të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

“Shërbimi ynë Informativ praktikisht është një shërbim që nuk kontrollohet nga askush. Ndërkohë që një shërbim inteligjent i një vendi normal demokratik, aq më tepër të një vendi të NATO-s, është institucioni më i kontrolluar i vendit, që kontrollohet nga disa nivele dhe nga disa këndvështrime. Madje, edhe publiku në shërbimet moderne ka të drejtën e kontrollit përmes përfaqësuesve publikë, sigurisht të aprovuar nga Kuvendi”, theksoi Lleshaj.

Ai kërkoi ngritjen e disa niveleve të kontrollit mbi Shërbimin, nga Parlamenti të administrata dhe përfaqësuesit e publikut, me qëllim që veprimtaria e inteligjencës të qëndrojë brenda kufijve ligjorë.

“Modelet e vendeve demokratike janë njëlloj dhe parimi numër një i tyre është përgjegjshmëria, llogaridhënia, kontrolli parlamentar, kontrolli administrativ, kontrolli publik. Pra, disa nivele kontrolli në mënyrë që Shërbimi të qëndrojë brenda hullive ligjore dhe të mos kompromentojë të drejtat e njeriut në funksion të sigurisë, sepse gjithmonë ka një balancë midis sigurisë dhe lirisë individuale”, tha ish-ministri.

Në fund, Lleshaj paralajmëroi se rasti i fundit mund të jetë vetëm një episod i zbuluar i një problemi shumë më të madh, pikërisht për shkak të mungesës së mekanizmave të fortë të kontrollit.

“Këto gjëra nuk janë trajtuar dhe është nevojë imediate, kombëtare që këto gjëra të zgjidhen, sepse ajo që ndodhi është vetëm një episod i radhës që është kapur, që mund të ketë ndodhur dhe 100 herë të tjera dhe nuk është kapur”, përfundoi Lleshaj.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 28 Shtator20:58

[Revolta qytetare në ditën e 121, protestuesit marshojnë drejt “Qytetit Studenti”: Pa rini nuk ka Shqipëri!](#)

Me thirrjet “pa rini nuk ka Shqipëri” dhe “duam dorëheqje”, qytetarët kanë vijuar marshimin e protestës së...

POLITIKE 28 Shtator20:53

[Nga dorëheqja e Ramës te qeveria teknike, aktivistja rikujton kërkesat e protestuesve](#)

Për të 121-tën ditë me radhë, qytetarët u mbledhën në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” në Tira...

POLITIKE 28 Shtator20:44

[“Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit”/ Zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama](#)

Duke folur në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, kreu i komanduar i SHISH, Elvis Lila, ka këmbëngulur se nga një auditim tep&eum...

POLITIKE 28 Shtator20:39

[Flamuj, pankarta dhe flakadanë! Protestuesit “ndezin” rrugët e Tiranës: Ju erdhi fundi!](#)

Flamuj, pankarta dhe flakadanë kanë shoqëruar marshimin e protestuesve në rrugët e Tiranës, në vijim të protestës s...

POLITIKE 28 Shtator20:21

[Aktivisti ‘ngre peshë’ sheshin: Rama nuk i shmangesh dot ndëshkimit të shqiptarëve!](#)

Një prej aktivistëve të protestës së 121-të kundër qeverisë ka lëshuar akuza të forta ndaj kryeministrit Edi R...

POLITIKE 28 Shtator20:07

[“Territorialja”/ Këshilli Bashkiak i Memaliajt voton kundër bashkimit me Tepelenën](#)

Këshilli Bashkiak i Memaliajt ka votuar kundër bashkimit të kësaj bashkie me Tepelenën. Bëhet me dije se nëntë anët...

POLITIKE 28 Shtator20:06

["Sa më shumë na kërcënon, aq më të vendosur bëhemi"/ I riu “shpërthen” në protestë: Rama jep dorëheqjen! Të duam në burg](#)

Një i ri ka mbajtur një fjalim me tone të forta gjatë protestës së 121-të kundër qeverisë, duke lëshuar nj&eum...

POLITIKE 28 Shtator19:58

["Rama i marrë peng"/ Protestuesi: Studentët të bashkohen masivisht, nga ky shesh do të dalin dhe liderët e kësaj republike](#)

Në protestën e 121 kundër kryeministrit Edi Rama, aktivisti Erald Noj bëri thirrje që shqiptarët të bashkohen nga çdo ...

POLITIKE 28 Shtator19:38

[“BE dhe SHBA, na ndihmoni ta heqim këtë qeveri të ndyrë”, profesori Lush Susaj thirrje shqiptarëve: Protestoni! Mos u kalbni në kafene e divane](#)

Profesori Lush Susaj, në fjalën e mbajtur në protestën e 121-të kundër qeverisë, u ka bërë thirrje fermerëve d...

POLITIKE 28 Shtator19:36

[“Jemi për kontratë të re sociale”, aktivistja: Rama të dorëhiqet dhe të shkojë në prokurori](#)

Mbahet sot protesta e 121 kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama. Qytetarët kërkojnë dorëheqjen e panegociueshme të Ram&e...

ME TE VIZITUARAT

LIFESTYLE 28 Shtator

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mir&e...

BOTA 27 Shtator

[Shpërthim gjatë fluturimit të avionit me pasagj...](#)

Një avion i Lufthansa-s, që po fluturonte nga Frankfurti drejt Lisbonës, u devijua të shtunën në mbrëmje, më 26 shtator,...

AKTUALITET 28 Shtator

["Do të më vrasin bandat"/ Shqiptari fiton të dr...](#)

Një gjyqtar britanik i dha anonimitet një shtetasi shqiptar, i dënuar disa herë për vjedhje dhe që përballet me dëbimi...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.